



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

**Drejtuar:** Operatori ekonomik "Kthella shpk"  
**Adresa:** Kompleksi Kthella Resort, Rruga "Shen Vicenzo De Paolo",  
perballË varrezava tË Qytetit Rreshen , Koder Rreshen, Mirdite

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** "Procedurë e Hapur" me objekt "Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Leandro Zoto"- "Maria Kraja" – "Disha" – "Sadik Petrela".

**Numri i referencës së procedurës/lotit** REF-50728-02-17-2020.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: "Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Leandro Zoto"- "Maria Kraja" – "Disha" – "Sadik Petrela".

**Fondi limit:** 206,644,117.48 (dyqind e gjashtë milion e gjashtëqind e dyzet e katër mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë pikë dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 10 (dhjete) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 19.05.2020, ora 11:00

**Publikime të mëparshme:** (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 7 datë 24.02.2020.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "ELDA-VL" Shpk; NUIS K67106202W

Vlera e ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH.

2. Operator ekonomik "Kthella" shpk NUIS J69303023D

Vlera e ofertës = 133,556,435 (njëqind e tridhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik "2 T" shpk & ALKO-IMPEX General Construcion. NUIS K01731001M & NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = 145,325,671.07 (njëqind e dyzet e pesë milion e treqind e njëzet e pesë mijë gjashtëqind e shtatëdhjetë e një pikë zero shtatë) lekë pa TVSH.

#### **4. Operatori ekonomik “BAMI” shpk**

**NUIS J94416206R**

Vlera e ofertës = 156,886,654 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

#### **5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE – IS” SH.P.K & “ ERGI” shpk. NUIS K71412003A NUIS K02727229P**

Vlera e ofertës = 158,896,724 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë shtatëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH.

#### **6. Operatori ekonomik A.N.K shpk**

**NUIS J92408001N**

Vlera e ofertës = 180,492,283.70 (njëqind e tetëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë dyqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

#### **7. Operatori ekonomik “Ante-Group shpk**

**NUIS J62904100D**

Vlera e ofertës = 200,524,970.3 (dyqind milion e pesëqind e njëzet e katër mijë nentëqind e shtatëdhjetë pike tre) lekë pa TVSH.

#### **8. Operatori ekonomik “4 AM”shpk**

**NUIS K92005016L**

Vlera e ofertës = 204,579,812.83 (dyqind e katër milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë tetëqind e dymbëdhjetë pike tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

### **Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

#### **1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ ELDA-VL” Shpk;**

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Elda -VL” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “ 2 T” shpk & ALKO-IMPEX General Construcion.**

- Operatori ekonomik “2T” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin

e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. (Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)” pasi është paraqitur dokumentacion për 2 mjekë ku për njërin rezultoi Urdhëri i Mjekut I pavlefshëm, lëshuar në datë 03.04.2015 me afat vlefshmërie 5-vjecar ndërsa me mjekun tjetër kontratat e punës është nënshkruar në datë 24.04.2020, pra nuk figuron në listpagesa për 6 muajt e fundit.

- BOE “2T” & “Alko-Impex General Construction” dshh nuk plotëson gërmën pikën 13 të kapacitetit teknik të DST pasi eskavatorët me goma CAT M313D dhe CAT M316C janë paraqitur vetëm me fatura zh’doganimi pa dokumentacionin e kërkuar cka bie në kundërshtim me kërkesat e gërmes “a” të kësaj pike: “Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit (e vlefshme)”.
  - BOE “2T” & “Alko-Impex General Construction” dshh nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të DST pasi nga 3 autobot uji të paraqitur 2 prej tyre konkretisht me targë AA629RD dhe AA863SD nuk kanë Çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit cka bie në kundërshtim me kërkesat e gërmes “a” të kësaj pike: “Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit (e vlefshme)”.
- 3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE – IS” SH.P.K & “ERGI” shpk.**
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 4 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik “List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shkurt 2019 - Janar 2020 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”, pasi nuk ka paraqitur List pagesat dhe urdhër pagesat për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhen *Shkurt 2019 - Janar 2020*.
  - Operatori Ekonomik “BE IS” nuk ka paraqitur “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1, cka bie në kundërshtim me Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit, germa b).
  - Operatori Ekonomik “BE IS” nuk ka paraqitur Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5, cka bie në kundërshtim me Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit, germa c).
  - Operatori Ekonomik “BE IS” nuk ka paraqitur Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7, cka bie në kundërshtim me Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit, germa ç).
  - Operatori Ekonomik “BE IS” nuk ka paraqitur Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1, cka bie në kundërshtim me Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit, germa d).
  - Operatori Ekonomik “BE IS” nuk ka paraqitur Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10, cka bie në kundërshtim me Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit, germa e).
  - Operatori Ekonomik “BE IS” nuk ka paraqitur Deklarate mbi kontratat e lidhura apo

ne proces, sipas Shtojcës 11, cka bie në kundërshtim me Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit, germa f).

#### 4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik A.N.K shpk

- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson kërkesat e kritereve të përgjithshme: “Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8” pasi nuk është paraqitur e plotë Shtojca 8 “deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” pasi nuk janë deklaruar emrat e personave që nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, si më poshtë...”* pasi nuk janë paraqitur diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore për punonjësit hidraulikë.
- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, si më poshtë...”* pasi nuk janë paraqitur diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore për punonjësit elektrikiste.
- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, si më poshtë...”* pasi nuk janë paraqitur diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore për punonjësit pllakashtrues.
- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, si më poshtë...”* pasi nuk është

paraqitur dokumentacioni i kërkuar (*si kontrate Pune, diplome/deshmi përkatëse, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme)*), për punonjësin e kërkuar, teknikë ndërtimi.

- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi nuk plotëson kërkesën për kamion me kapacitet 7-10 ton, pasi kamionët me targë AA634PI dhe AA148PX janë mbi kapacitetin e kërkuar, respektivisht, 23,5 ton dhe 22.6 ton.
- Operatori ekonomik “A.N.K” shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi asnjë nga kamioncinat nuk plotëson kapacitetin e kërkuar, 3.5-5 ton, konkretisht kamioncina me targë TR7090H me kapacitet 3,1 ton dhe kamioncina me targë TR3807P me kapacitet 3,2 ton.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik “Kthella” shpk me adresë: Kompleksi Kthella Resort, Rruga "Shen Vicenzo De Paolo", perballë varrezava tË Qytetit Rreshen , Koder Rreshen, Mirdite se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 133,556,435 (njëqind e tridhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 03.06.2020**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqitur asnjë ankesë.